



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

EC MA NDRYSHE RAPORT I PUNËS 2019

Rr. Fehmi Lladrovci 94, 20000/Prizren ~ Bulevardi Nënë Tereza H30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë
ëëë.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771

QASJE E RE STRATEGJIKE DHE PROGRAMET

Plani Strategjik i EC-it është i ndërtuar mbi tri qëllime strategjike të cilat brenda vetes kanë objektiva strategjike që përshkruajnë në detaje më të mëdha se si do të përmbush dhe të arrijë EC misionin dhe vizionin e saj, respektivisht:

- Rritja e mundësive dhe njohurive për bashkëveprim me qytetarët,
- Kuptim dhe avokim më i mirë rreth nevojave dhe alternativave për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve,
- Përmbushje e misionit duke menaxhuar me efikasitet resurset njerëzore dhe teknologjike.

EC është organizatë e komunitetit që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje transparente dhe llogaridhënëse.

Duke filluar nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe:

1. *Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit)*
2. *Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim)*
3. *Hulumtimi (prodhim i dijes)*

Shtrirja gjeografike

Fokusi i EC do ishte në Prizren dhe Prishtinë, ndërsa iniciativa të caktuara u realizuan edhe në komunat e tjera, kryesisht ato të rajonit të Prizrenit. Prej vitit 2015, EC ka shtrirë aktivitetin edhe në pesë komunat tjera të mëdha (Gjakovë, Pejë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Ferizaj) kurse prej vitit 2018 nëpërmjet projektit “AktRural” dhe “Indeksi i Transparcës...” EC është shtrirë në shumicën e komunave të Kosovës. Si pjesë e avokimit për mbrojtjen e qendrave historike të Kosovës, përveç QH Prizren, EC nga fillimi i vitit 2015 po i vëzhgon edhe qendrat historike të Gjakovës, Prishtinës, Pejës dhe Mitrovicës. Edhe gjatë vitit 2019 EC ka mirëmbajtur prezencën e vet në këto komuna.

PROJEKTET

Gjatë vitit 2019 është punuar në shtatë projekte. Projektet e organizatës gjatë vitit 2019 kanë patur këtë shtrirje gjeografike brenda Kosovës: Prizren, Mamushë, Malishevë, Suharekë, Dragash, Rahovec, Gjilan, Kamenicë, Viti, Kacanik, Hani i Elezit, Ferizaj, Shtime, Shtërpce, Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Istog, Decan, Junik, Klinë, Mitrovicë, Vushtrri, Fushë Kosovë, Podujevë, Junik.

AktRural (RuralAct) – aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës

Projekti ka filluar në shkurt të vitit 2018 dhe ka përfunduar në nëntor 2019. Projekti ka synuar të kontribuojë në zbutjen e niveleve të përjashtimit social të të rinjve në zonat rurale duke rritur mundësitë e angazhimit të tyre në nisma të aktivizmit, vullnetarizëm dhe aktivitete jashtë kurrikulare. Objektivat e projektit kanë qenë: Angazhimi aktiv i rinisë për qytetari aktive dhe përfshirje sociale është rritur; Rinia është e informuar dhe e përfshirë në procese vendim-marrëse; Rinia përfshihet në iniciativa vullnetare për kauza sociale; Rinia përfshihet në aktiviteteve jashtë-kurrikulare.

Qytetet Gjithëpërfshirëse...

Nga viti 2019, me projektin "Qytetet Gjithëpërfshirëse..." kemi zgjeruar punën edhe në qytete tjera si në Dragash, Malishevë, Suharekë, Rahovec, Gjakovë, Ferizaj dhe Gjilan. Gjatë vitit 2019 projekti ka nxitur veprime në të gjitha lagjet e qytetit dhe në disa fshatara në Prizren si dhe në qytetet tjera me një numër solid rastesh që kanë gjetur zgjidhje brenda kësaj periudhe. Projekti ka qenë prezent në hapësirën publike përmes performansave, të cilat po i artikulojnë kërkesat e qytetarëve në formën e aktivizmit kulturor dhe urban. Për qëllime të projektit është ndërtuar dhe është duke u përditësuar me informacione edhe portali *mahalla.info*, që synon të shndërrohet në adresën kryesore të informacionit mbi gjendjen në lagjet e qytetit.

EKO Shkolla

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ka qenë të avokojë për futjen e konceptit të EKO shkollës në shkollat e Prizrenit përmes pilotimit të modelit dhe metodologjisë përkatëse të mbrojtjes së mjedisit me pjesëmarrjen e gjerë të nxënësve dhe mësuesve në një shkollë të përzgjedhur në mënyrë konkurruese. Në shkolla kryeson teoria para praktikës, me mundësi praktikisht jo ekzistente për t'u angazhuar në aktivitete sociale dhe komunitare. Në përgjigje të kësaj nevojë, EC Ma Ndryshe ka hartuar këtë projekt, i cili është bazuar në konceptin "eko shkollor", një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, por që po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Eko Shkolla është një metodologji e provuar, pasi ndër të tjera përfshin të gjithë, përmirëson mjediset shkollore, motivon të rinjtë dhe përfshin komunitetet.

Objektivat specifike të projektit kanë qenë:

- Rritja e ndërgjegjësimit tek nxënësit dhe mësuesit, e ndjekur nga masat praktike dhe aktivizmi që synojnë mbrojtjen e mjedisit
- Promovimi i gjerë publik dhe avokim publik ndaj komunës dhe shkollave publike për të miratuar dhe zbatuar formalisht metodologjinë e "Eko Shkollës".

Monitoruesi Mjedisor

Qëllimi i projektit është të ndihmojë në përmirësimin e paramentrave mjedisorë në rajonin e Prizrenit përmes një sistemi të strukturuar monitorimi dhe publikimi të informacionit mjedisor. Projekti është përpjekje e EC Ma Ndryshe për të fuqizuar argumentin avokues të shoqërisë civile dhe medias si mënyrë e nxitjes së vëmendjes institucionale në përmbushjen e detyrimeve mjedisore që dalin nga MSA. Projekti ka këta dy objektiva specifike:

- Sistem i zhvilluar i monitorimit të përhershëm dhe publikimit të të dhënave mbi parametrat mjedisorë në rajonin e Prizrenit, dhe
- Avokim më efektiv publik i shoqërisë civile dhe medias karshi institucioneve publike në përmbushjen e detyrimeve mjedisore të MSA-së.

Projekti synon një numër grupesh që janë përfituese dhe përdoruese të informacionit përfundimtar mjedisor që do të gjenerohet gjatë zbatimit, përfshi: aktivistët e shoqërisë civile (ambientalistët), autoritetet publike (lokale dhe qendrore), gazetarët dhe mediat që raportojnë për parregullsitë mjedisore, ndërmarrjet e shërbimeve publike, kompanitë private, organizatat ndërkombëtare që monitorojnë mjedisin dhe mbi të gjitha publiku i gjerë, qytetarët e komunave të rajonit të Prizrenit, shëndeti dhe mirëqenia e të cilëve është drejtpërdrejtë e lidhur dhe e ndikuar nga paramentrat mjedisorë.

rePublic Spaces

Objekti i përgjithshëm i këtij projekti është promovimi i hapësirave publike të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të qasshme në Prizren nëpërmjet dialogut të politikave, projekteve të hartuara dhe të demonstruara nga komuniteti, të cilat synojnë përmirësimin e jetesës së banorëve dhe komuniteteve të pafavorizuara. Rezultatet e projektit kanë qenë:

- Banorët e lagjeve, grupet e komunitetit, OSHC-të dhe profesionistët të përfshirë drejtpërdrejtë për të kontribuar në hartimin e vizionimit;
- Demonstrimi i projekteve për hapësira publike që bazohen në hartim të vizionimit dhe përmirësim të përgjithshëm të cilësisë së hapësirave publike në lokacionet e përzgjedhura;
- Qasja tek qytetarët është bërë nëpërmjet mjeteve të komunikimit të cilat theksojnë kuptimin dhe rëndësinë e hartimit dhe menaxhimit të hapësirave publike;
- Fuqizim të dialogut të strukturuar ndërmjet autoriteteve komunale dhe grupeve të komunitetit (duke përfshirë OSHC-të) për një kornizë më të mirë të politikave për menaxhim të hapësirës publike;
- Krijimi i një platformë online e resurseve për hartimin dhe menaxhimin e hapësirës publike të cilat avancojnë në inkurajimin e projekteve të reja për hapësira publike në bashkëpunim me autoritetet dhe komunitetin.

Përkrahje për Prizrenin e Qëndrueshëm – ADLK Urbane/Urban NAMAs (Akcionet e Duhura Lehtësuese në nivel Kombëtarë/National Adequate Mitigation Actions)

Qëllimi i këtij projekti ka qenë është hartimi i një studimi fillestarë për qytetin e Prizrenit për të identifikuar rreziqet potenciale me bazë gjinore që ndërlidhen me ndryshimet klimatike për sektorë, dhe të specifikohen nevojat prioritare të burrave, grave dhe grupeve të marginalizuara në lidhje me ADLK urbane për përfshirjen e tyre në Planin Veprues Ndërsektorial. Rezultati kryesor i pritur ka qenë përgaditja e studimit fillestarë për qytetin e Prizrenit që u realizua përmes metodës sasiore dhe cilësore për të cilin studim janë mbledhur informata përmes 30 intervistave të strukturuar dhe organizimit të pesë fokus grupeve me së paku 10 pjesëmarrës secila.

Filigrani përtej Artizanatit

Qëllimi i këtij projekti ka qenë të kontribuojë në ruajtjen e artizanatit të filigranit nëpërmjet dokumentimit, promovimit dhe transferimit të njohurive dhe shkathtësive tek gratë dhe të rinjtë duke çuar në rritjen e punësueshmërisë së tyre. Objektivat e projektit dhe rezultatet përkatëse kanë qenë:

- Të transferojë njohuritë dhe aftësitë e artizanatit të filigranit tek gratë dhe të rinjtë nëpërmjet programeve të edukimit dhe zhvillimit të kapaciteteve,
- Të dokumentojë dhe promovojë artizanatin e filigranit si një aset i trashëgimisë kulturore jomateriale në prag të zhdukjes
- Zhvillimi i një kuadri strategjik të menaxhimit që synon transformimin e Filigranit në një ndërmarrje të qëndrueshme.

Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut

Projekti “Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut” synon të kontribuojë në përmirësimin e njohurive të të rinjve dhe pjesëmarrjen e tyre në mbrojtjen dhe promovimin e kulturës dhe trashëgimisë së Istogut. Grupi kryesor i synuar i projektit janë fëmijët e shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Istogut.

- Organizimi i trajnimit të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme për trashëgiminë kulturore dhe natyrore (rreth 30 pjesëmarrës)
- Hartimi i ‘Librit të trashëgimisë: trashëgimia siç shihet dhe interpretohet nga nxënësit’
- Hartimi i Udhëzuesit për përfshirjen e mësimin praktik të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në kurrikulën shkollore
- Hartimi i strategjisë dy vjeçare për zhvillim të grupit jo formal – Shoqata e të Rinjve për Trashëgimi
- Themelimin e grupit jo formal – Shoqata e të Rinjve për Trashëgimi

Peticion për mbrojtje të lumenjëve

Qëllimi i projektit është mbrojtja e lumenjeve dhe përmirësimi i paramentrave mjedisorë në rajonin e Prizrenit përmes një peticioni. Projekti është përpjekje e EC Ma Ndryshe për të fuqizuar argumentin avokues të shoqërisë civile dhe qytetareve si mënyrë e nxitjes së vëmendjes institucionale në mbrojtjen e lumenjeve, dhe përmbushjen e detyrimeve mjedisore që dalin nga MSA.

Projekti synon të bashkëpunojë dhe t'i involvtojë edhe aktivistët e shoqërisë civile (ambientalistët), autoritetet publike lokale, gazetarët dhe mediat që raportojnë për parregullsitë mjedisore, qytetarët e komunave të rajonit të Prizrenit, shëndeti dhe mirëqenia e të cilëve është drejtpërdrejtë e lidhur dhe e ndikuar nga paramentrat mjedisorë.

Iniciativat tjera

1. **Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (Gjykatë e Hapur)** - Edhe gjatë vitit 2019, projekti ka vazhduar në formën e iniciativës “Gjykatë e Hapur” dhe realizohet pa përkrahje financiare. Komponentë esenciale e projektit është lehtësimi i komunikimit të grupeve të komunitetit me shërbyesit e drejtësisë. Zyra për Informim e Gjykatës tashmë operon me një numër mjedesh të përhershme të komunikimit (profilet në mediat sociale, buletini tre-mujor informues, programe ‘vizito Gjykatën’, etj). Edhe gjatë vitit 2019 është zbatuar programi i praktikës për studentët në Zyrën për Informim të Gjykatës, i cili realizohet në partneritet me EC, Gjykatës Themelore dhe Universitetit të Prizrenit.
2. **Politikat kulturore lokale (RrOK Prizren)** – rrjetëzimi lokal i skenës së pavarur kulturore është ndër zhvillimet më të rëndësishme në sektorin e kulturës në Prizren. Si pjesë e këtij rrjeti, EC ka vazhduar të angazhohet për zhvillimin e politikave kulturore lokale në Prizren, që do të sigurojnë zbatim konkret të zotimeve për zhvillim ekonomik përmes kulturës të vendosura në Planin Zhvillimor Komunal 2025 të Prizrenit.
3. **Kino Lumbardhi** – iniciativa për mbrojtjen e kinos ka ofruar një shembull të mirë se organizimi dhe bashkimi mund të sjellë efekte të dëshiruara. Angazhimi për Kino Lumbardhin ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019, ndërsa gjatë kësaj periudhe është duke u punuar hartimi i planit të menaxhimit të këtij monumenti, si dhe janë kryer disa punime restauruese në objekt dhe shume aktivitete tjera të cilat menaxhohen nga Fondacioni Lumbardhi.
4. **Rrjetëzimet** – EC ka vazhduar të konsolidojë pozitën e vet brenda rrjeteve nacionale dhe rajonale, ndërsa si pjesë e tyre ka ndihmuar në iniciativat e shoqërisë civile në nivelin qendror, përfshi zbatimin e strategjisë së bashkëpunimit mes qeverisë dhe shoqërisë civile (përmes Civikos), hartimin e strategjive shtetërore të kulturës dhe trashëgimisë kulturore (përmes Forumit

Kulturor), etj. EC ka themeluar edhe kapitullin e Kosovës në rrjetin global INTBAU (fondacion i Princit Charles).

5. **Bashkëorganizimi i aktiviteteve** – EC edhe gjatë vitit 2019 ka ndihmuar organizatat e shoqërisë civile nga qytetet tjera për të realizuar aktivitete me tema të ndryshme në Prizren. Disa nga organizatat që ka bashkëpunuar në realizim të aktivitete janë: IPKO Fondation, FOL, D+, INPO, GAP, INDEP, FIQ , D4D, ATRC, YIHR, USAID,CIVIKOS etj.

PUBLIKIMET

Gjatë të vitit 2019, organizata ka realizuar dymbëdhjetë publikime (analiza, dokumente të politikave, raporte, studime hulumtuese, vizionime për qytetin, buletinë) si dhe pesëmbëdhjetë video produkte.

DONATORËT

KFOS
KCSF
OPIC
UN-HABITAT
UNDP

Raporti vjetor i punës për vitin 2019 u miratua në takimin vjetor të Kuvendit të Anëtarëve të EC Ma Ndryshe, mbajtur më 13 Prill 2020, në Prizren.

Në emër të Kuvendit të Anëtarëve
_____, kryesues i Kuvendit të Anëtarëve

Në emër të stafit të organizatës
Valon Xhabali, drejtor ekzekutiv